



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE NË FAKULTET
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 09 prot.

Shkodër më 20/06/2024

VENDIM

Nr. 09 datë 20/06/2024

Për mënyrën e votimit për Senatin Akademik nga stafi akademik i FE

Komisioni zgjedhor i Fakultetit Ekonomik (KZF-FE), duke u nisur nga mungesa e nje udhezimi zyrtar nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, mbi menyren e votimit dhe vleresimit të votës së stafit akademik të FE për senat akademik, KZF-FE në mbledhjen e tij të datës 20.06.2024, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhrin nr. 101, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, datë 13.03.2024 "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Shkodrës", në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH", në ambjentet e FE me pjesëmarrje të plotë, në mënyrë unanime vendosi:

1. Të zbatohet Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH" Nr. 106, datë 20.02.2020.
2. Të zbatohet nenin 35, pika 5 te kësaj rregullore.
Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a. fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ-i;
 - b. fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;
 - c. në fletën e votimit janë bërë shënime ose shenja të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore;
 - d. në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
 - e. është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit për autoritetet drejtuese;
 - f. nuk është votuar për asnjë nga kandidatët në fletën e votimit;
 - g. nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person ose subjekt që nuk është në fletën e votimit.
 - h. fletet e votimit për anëtar SA nga staf akademik dhe student quhet e pavlefshme kur ka më pak ose më shumë zgjedhje se sa numri i mandateve të njësisë kryesore.
3. Të vlerësojë të vlefshme fletën e votimit për Senat Akademik kur votohet për 3 kandidatë (as më pak dhe as më shumë), dhe në rastin kur votuesi shënon edhe pro edhe kundër për të paktën njërin nga kandidatët fleta e votimit vlerësohet e pavlefshme.

Anëtar

Sekretar

Albana Kastrati

Arian Gjura

Sead Baraku

Edmond Arrneni